



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo  
Komuna - Municipality Assambly  
Hani i Elezit



01/Nr. 8521/2023  
Data : 09.10.2023

### PROCESVERBALI I KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

Nga mbledhja e nëntë -IX- për vitin 2023 e Komitetit për Politik dhe financa, mbajtur me datë 19.09.2023 me fillim pune ne ora 11:00 në sallën e takimeve. Të pranishëm ishin: **Sevdi Dernjani** (Nënkryetar i Komunës), **Lindita Ballazhi** (Drejtoresh për Buxhet dhe Financa), **Natyra Kalisi** (Drejtoresh e Administratës), **Nexhmedin Daci** (Drejtor për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), **Abduraman Bushi** (Drejtor për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural), **Majlinda Kaloshi** (Drejtoresh për Zhvillim Ekonomik), **Kimete Kuka - Hasallari** (Drejtoreshë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), **Sara Berisha** (Asistente e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës), **Vjosa Rogaçi** (Zyrtare në Drejtorin e Arsimit) .

#### RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Buxheti i komunës për vitin 2024 dhe parashikimet buxhetore për vitin 2025-2026.
3. Plani i punës së kuvendit të komunës për vitin 2024.
4. Informatë mbi fillimin e vitit të ri shkollor 2023/2024.
5. Hartimi i Strategjisë për Zhvillim Ekonomik 2023/2027.
6. Të ndryshme

**Kryesuesi** thekson:- për pikat e rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte një zëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

## 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin,

**Sherif Berisha** thekson:- kërkoj që të shtohet në procesverbal ofendimi i nënkryetarit të komunës që ka potencuar se nga një herë është shumë e rëndësishme mos mbajtja e lirimit të gazrave se kur i mbanë prej boshtit kurrizorë shkojnë në krye dhe jep mendime të ndyta.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

### U MIRATUA PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

## 2. Buxheti i komunës për vitin 2024 dhe parashikimet buxhetore për vitin 2025-2026.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Lindita Ballazhi** thekson:- buxheti i komunës është hartuar në bazë të qarkores të cilën e ka dërguar Ministria e Financave. Janë mbajtur dëgjimet buxhetore dhe propozimet e qytetarëve i kemi analizuar dhe i kemi përfshirë në planifikimet buxhetore. Buxheti për vitin 2024 është në shumë prej 3,349,278.00 €. Në kategorinë paga dhe shtesa janë planifikuar 2,075,272.00 €, në kategorinë mallra dhe shërbime janë planifikuar 524,500.00 €, në kategorinë shpenzime komunale janë planifikuar 93,500.00 €, në kategorinë subvencione dhe transfere janë planifikuar 113,000.00 €, në kategorinë e shpenzimeve kapitale janë planifikuar 543,006.00 €.

**Sherif Berisha** thekson:- nga ndarja në kategori buxhetore shihet se keni bërë keq klasifikim të buxhetit. Pjesa më e madhe e buxhetit të komunës shkon në kategorinë për paga dhe mëditje, në mallra dhe shërbime buxheti është ndarë në 16 % dhe për çfarë shërbime kontraktuese janë planifikuar këta mjete financiare. Në cilin sektorë do të shkojnë planifikimi i subvencioneve që keni propozuar për me i rritur. Në drejtorinë për shëndetësi nuk ka asnjë projekt të planifikuar në këtë buxhet kur dihet që kemi mungesë të mjekëve familjarë, mungesa e mjekut në fshatin Gorancë, mungesa e aparaturave . Pse nuk përputhen të hyrat e planifikuara të vitit 2023 të cilat i keni dorëzuar në thesar me raportin e të hyrave të këtij viti, a keni gabuar në planifikim apo nuk keni mundur që t'i inkasoni. Sa procedura përbarimore janë në proces sa i përket shujtave në arsim , shpenzime të udhëtimit , kualifikimit dhe inflacionit.

**Lindita Ballazhi** thekson:- te pagat dhe shtesat nuk ka keq planifikim por duhet që t'i planifikojmë për shkak se paga është diçka e shenjtë që i takon çdo njërit dhe nuk duhet që askush të mbetet pa pagë dhe në këtë vit koeficienti është 105 € ndërsa për vitin 2024 koeficienti do të jetë 110 € pra kemi rritje. Sa i përket mallrave dhe shërbimeve të gjitha drejtoritë i kanë prezantuar planet e veta të punës që do të kryhen gjatë vitit 2024. Subvencionet janë planifikuar te drejtoria e zhvillimit ekonomik dhe kemi shtesë te shërbimet publike për shkak të rritjes së shpenzimeve të varrimit. Për çështje të procedurave të përbarimit nuk kemi informacion të saktë dhe duhet të marrim prej zyrës ligjore këtë përgjigje.

**Sevdi Dernjani** thekson:- të gjithë e dimë që planifikimi i të hyrave nuk korenspononë me realitetin në praktikë, nëse është planifikuar në vitin 2022 që për vitin 2023 kemi me i pasur të hyrat 300,000.00€ nuk nënkupton që domosdoshmërisht që duhet me i pasur 300,00.00€ sepse në praktikë nuk kanë ndodhë për shkak se bizneset kanë pasur vështirësi , qytetarët nuk kanë mundur me i kryer obligimet.



**Kimete Kuka -Hasallari** thekson:- sa i përket investimeve kapitale për këtë vit është paraprë depoja në QKMF të cilën e kemi si obligim ligjorë , ndërsa për vitin e ardhshëm nuk është planifikuar për shkak se nuk kemi diçka që duhet të investohet. Sa i përket mjekëve specialistë sipas udhëzimit administrativ nuk kemi të drejtë, ndërsa investimet për aparatura janë të paraparë prej mallrave dhe shërbimeve.

**Sherif Berisha** thekson:-me leje të kujt është nxjerrë jashtë QKMF-së shtrati i emergjencës.

**Kimete Kuka -Hasallari** thekson:- nuk e kam këtë informacion për këtë çështje.

**Refet Kalisi** thekson:- pse është kjo rënie e të hyrave vetanake për vitin 2024 . Tatimi në tokë për vitin 2023 është 117,000.00 €, ndërsa për vitin 2024 është në shumë prej 32,000 €. Shtrimi me kupëza betoni në rrugica dhe trotuare në Han të Elezit , në fshatin Paldenicë , Seqishtë, Dimçë , Pustenuik , Gorancë, Dermjak, Rezhancë , Krivenik dhe për këto rrugë janë planifikuar 35 000 € a mbulohen me këto mjete financiare . Ndërtimi i parkut në fshatin Paldenicë por unë mendoj që në fshatin Paldenicë bukur kemi investuar por duhet të analizohet se ku do të investojmë . Rregullimi i hapësirave publike me kupëza betoni dhe gjelbërim në rrugën dëshmorët e kombit, Isa Berisha në Han të Elezit ku kanë mbetur këto rrugë pa u shtruar . Ndërtimi i objektit të shkollës në Lagje të Re 29 000 € , a ndërtohet objekti me këtë shumë .

**Lindita Ballazhi** thekson:- projeksi i të hyrave vetanake për vitin 2024 është në shumë prej 274, 367.00 € që ka qenë prej neve sepse shumicën e borxheve mendojmë që t'i inkasojmë brenda këtij viti. Tatimi në tokë dhe tatimi në pronë nuk përcaktohen nga komuna jonë por është e përcaktuar nga departamenti i tatimit në pronë nga Ministria e Financave që është bërë nga vlerësimi i tyre.

**Nexhmedin Daci** thekson:- shtrimi i rrugëve me kupëza betoni është planifikuar në këtë mënyrë për shkak se Ministria përkatëse e ka kërkuar. Ndërtimi i parkut në fshatin Paldenicë ka qenë kërkesë e qytetarëve për me hyjë si projekt . Rregullimi i hapësirave publike ka të bëjë me lokalet që do të prishën në vitin e ardhshëm . Mjetet financiare për ndërtimin e shkollës janë ndarë për me qenë si kod.

**Kryesuesi** thekson:- planifikimin të cilin e keni bërë a e bëni për të mirë të qytetarëve apo ju qysh doni vet sepse këtë planifikim që e keni bërë i bien që ju fjalën e qytetarit nuk e keni marr parasysht dhe nëse është në praktik kjo nuk është në rregull. Në debate publike nuk kam marr pjesë në të gjitha por në disa debate që kam marr pjesë kërkesat e banorëve në planifikime buxhetore nuk janë marr parasysht dhe nuk e kuptoj arsyen se pse nuk janë marr parasysht por ka shumë kërkesa më të rëndësishme se sa këto të cilat i keni planifikuar. Pse është paraprë rregullimi i rezervarit për ujë të pishëm në vitin 2025 në fshatin Seqishtë sepse është projekt me rëndësi. Rregullimi i prockave dhe kanalizimeve është dashur me u potencuar se në cilin fshat ka me u rregulluar . Ndërtimi i mbikalimeve të rruga “Martirët Bushi” 30 000 € . Ndërtimi i aneksit të Ura e Seqishtës. Restaurimi i objekteve me trashëgimi kulturore.

**Sevdi Dernjani** thekson:- te planifikimi buxhetorë janë 543,000.00 € dhe kemi mbajtur dëgjime buxhetore në secilin fshat dhe i kemi dëgjuar kërkesat e banorëve dhe kërkesat e tyre janë të përfaqësuara prej administratorëve të fshatrave të cilët na i sjellin kërkesat specifike , mirëpo ka edhe kërkesa të banorëve të cilat janë të rëndësishme por kur jemi takuar si ekzekutiv e kemi parë të arsyeshme që këto kërkesa me hyrë në planifikime sepse e kemi një buxhet prej 543,000.00 €. Afër 60 % e planifikimeve janë të kabinetit të Kryetarit të Komunës dhe 40 % janë kërkesa të qytetarëve . Nuk mundemi investimet kapitale me i orientuar në bazë të kërkesave të individëve që janë në Han të Elezit por jemi bazuar në kërkesat e administratorëve të fshatrave të cilat i kemi marr parasysht.



**Kryesuesi** thekson:- më e rëndësishme është rregullimi i rrugës alternative në fshatin Gorancë se sa parku te AMF-ja. Më i rëndësishëm është rregullimi i ujërave atmosferik me u rregulluar në fshatin Paldericë se sa rregullimi i parkut për të cilin edhe vendin nuk e dini se ku ka me u rregulluar . Më e rëndësishme është me u paraparë rezervari në fshatin Seqishtë sepse është e nevojshme për banorët. Rruga nër Bregë në fshatin Seqishtë është shumë me rëndësi sepse fshatarëve u hapë rrugën . Rruga “Nehat Curri” është me rëndësi me u rregulluar .

**Sevdi Dernjani** thekson:- si kabinet e kemi parë të arsyeshme me i përcaktuar këto hapësira publike si parkun “Isa Berisha”, Hapësira publike për rreth lumit Lepencë, Hapësira Publike tjerat të cilat janë duke u investuar dhe është mirë me u identifikuar si hapësira e në të ardhmer nëse xhindet buxhet për mirëmbajtjen e tyre është në domenin tonë por është shumë e rëndësishme me u identifikuar si parcela të parqeve . Ne jemi të vetëdijshëm për të gjitha kërkesat të cilat kërkohen por këto mjete financiare i kemi për investime kapitale nuk kemi më shumë.

**Refet Kalisi** thekson:- nuk jam kundër rregullimit të parqeve por shumë prej 20 000 € më mirë do të ishte me shfrytëzuar për rihapjen e rrugës për në Vorba për shkak se qytetarët kanë filluar me ndërtuar në atë pjesë dhe janë 200 hektarë tokë të cilën qytetarët nuk mundën me dal atje.

**Sevdi Dernjani** thekson:- ne i kemi planifikuar projektet të cilat i kemi vlerësuar se janë të domosdoshme .

**Nexhmedin Daci** thekson:- buxhetin e miraton Kuvendi i Komunës dhe propozimet mund t'i parashtroni në Kuvendin e Komunës. Në vitin 2024 kanë me u bërë testimet se a i plotëson kushtet apo nuk i plotëson për me bërë ndërtimin e aneksit te Ura e Seqishtës, Restaurimi i objekteve me trashëgimi kulturore është obligim ligjorë që duhet me i bërë . Për çështjen e rezervarit të ujit në fshatin Seqishtë kompania ”Sharrcem” e ka angazhuar një grup të ekspertëve të cilët kanë me bërë një hulumtim. Depon e mbejeve të ngurta e kemi obligim ligjorë. Mbikalimi te rruga “Martirët Bushi” Ministria e Infrastrukturës e ka angazhuar një kompani për me hartuar projektin, ndërsa shuma që është në listë të projekteve është për shpronësim të pronave private të cilat duhet t'i bënë. Në listë të projekteve propozoj që të hynë zgjerimi i rrugës “11 Qershori”, këtë projekt ka me financuar Ministria e Infrastrukturës dhe një pjesë me financuar Komuna.

**Kryesuesi** thekson:- unë nuk do ta votojë këtë planifikim të buxhetit sepse janë paraparë gjërat ashtu qysh ju kanë tek personave. A keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte 1 për , 4 kundër.

### **3. Plani i punës së kuvendit të komunës për vitin 2024.**

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Sherif Berisha** thekson:- propozoj që në kuadër të këtij plani për muajin tetor të hyjnë edhe dy pika të rendit të punës, Informatë për çështjen e ujit, Informatë për qendrën për punë sociale.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

**U VOTU PALNI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2024 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**



#### 4. Informatë mbi fillimin e vitit të ri shkollor 2023/2024.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Sherif Berisha** thekson:- nuk kam marr përgjigje prej drejtorisë së arsimit të cilat i kam parashtruar dhe është mirë me najë dërguar. Te shkolla fillore “Ilaz Thaçi” nuk janë kryer ende punimet është mirë me na njoftuar për këtë çështje.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

**U VOTU INFORMATA MBI FILLIMIN E VITIT TË RI SHKOLLOR 2023/2024 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

#### 5. Hartimi i Strategjisë për Zhvillim Ekonomik 2023/2027.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Majlinda Kaloshi** thekson:- është dokument që i përfshinë të gjitha sektorët që janë me rëndësi për zhvillimin e Hanit të Elezit . Së bashku me shkresën ua kemi përcjell vendimin e komisionit i cili është i bazuar në udhëzim administrativë.

**Kryesuesi** thekson:- prej legjislativit pse nuk është përfshirë ndonjë anëtarë në këtë komision.

**Majlinda Kaloshi** thekson:- pjesë e grupit të interesit janë palët të cilët janë të parapara sipas udhëzimit administrativ .

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

**U VOTU HARTIMI I STRATEGJISË PËR ZHVILLIM EKONOMIK 2023/2027 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

#### 7. Të ndryshme.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Sherif Berisha** thekson:- sa aplikant kanë përfituar subvencione në drejtorinë e bujqësisë dhe sa prej tyre kanë mbetur pa përfituar. Përgjigjet me shkrim nuk i kam pranuar nga drejtorët. Rrugët në komunën e Hanit të Elezit ende figurojnë si parcela private dhe është mirë me marr iniciativë për me i bërë publike. Sa është shuma e mjeteve financiare që ka investuar Qeveria e Kosovës në parkun “Isa Berisha”

**Sevdi Dernjani** thekson:- te çështja e rrugëve private është pak problem se planifikimet të cilat janë bërë ndër vite se kam hasur në shumë parcela private po ndoshta edhe publike që janë të institucioneve qendrore dhe të shpronësimeve që janë në shfrytëzim njëqind vjeçar ka shumë dhe kur fillojnë me u bartur nuk mundem me dhënë përgjigje. Për parkun “Isa Berisha” Qeveria e Kosovës i ka dhënë 100 000 €.

**Abduraman Bushi** thekson:- komuna nuk ka ndarë subvencione.

**Refet Kalisi** thekson:- rrugët janë bërë me marrëveshje që janë shtruar por varet ekzekutivi për çështje të iniciativës. Çështja e ujit nuk ka orar se kur ndërprehet është mirë të njoftohen qytetarët.


**Sevdi Dernjani** thekson:- nëse keni marrëveshje është mirë me najë dhënë sepse ka raste që potencojnë që kanë bërë marrëveshje me z.Refet Kalisi por marrëveshje nuk kemi me shkrim. Te çështja e ujit jemi me një proces të vendosjes së orëmatësve dhe është tu pasur keqpërdorime të mëdha.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e shpalli të mbyllur mbledhjen.

Mbledhja përfundoj në ora 12:56.

**Procesmbajtësi**

**Ayni Bushi**



**Kryesuesi i Kuvendit**  
**Florim Shkreta**

